



Pranuar / Doretuar Primjeny/Prodato Received/Delivry	26.04.2022	2	viti god year
Organ /Njesta Organ /Jedinica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPM/SHK	2431/2022		113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.247/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani– anëtarë, Zyle Millaku-Gojnovci, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.247/2022, të datës 17.03.2022 të parashtruar përmes postes së Kosovës nr. R1906476.nga ankuesi kundër organit të punësimit Komuna e Skenderajt, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës /në seancën për këshillim dhe votim me datë 22.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.247/2022 të datës 17.03.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi ka qenë kandidat i cili ka aplikuar në konkursin e shpallur nga Komuna e Skenderajt në pozitë: “Punëtor teknik” në SHFMU”Halit Geci” në Llaushë, i cili për shkak të mos përzgjedhjes së tij në këtë procedurë të rekrutimit, me datë 21.02.2022, ka parashtruar ankesë në Komisionin për Shqyrtimin dhe Zgjedhjen e Ankesave në Komunë të Skenderajt.

Me datës 03.03.2022 Komisioni për Shqyrtimin dhe Zgjedhjen e Ankesave në Komunë të Skenderaj, ka nxjerrë Vendimin me nr.2688/2022, me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar, duke lënë në fuqi Listën e kandidatëve të datës 18.02.2022 me nr.2668/2022, nga ana e Komisionit përzgjedhës.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin e datës 03.03.2022, me datë 15.03.2022 përmes postës së Kosovës me numër postar R1906476, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila me datë 17.03.2022 është pranuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokollit 1422/2022.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroj këto prova:** Ankesën A.nr.247/2022 të datës 17.03.2022 me numër te protokollit 1422/2022, e parashtruar nga ankuesi për Këshillin e Pavarur







**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda A.nr. 247/2022**

Zyler Millaku-GOJNOVCI

  
Procesmbajtëse

Malsore Gashi BAJRAKTARI



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Skenderajt
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Skenderajt dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;